

QYTETI I SHKUPIT

Në përputhje me Programin për subvencionimin e qytetarëve për blerjen e pajisjeve më bashkëkohore për ngrohje për vitin 2019 („Lajmëtari zyrtar I Qytetit të Shkupit “ nr.2/19), Qyteti i Shkupit shpall

THIRRJE PUBLIKE

për subvencionimin e qytetarëve për blerjen e pajisjeve më bashkëkohore për ngrohje kondicionerë inverter për vitin 2019

1. Përshkrimi i Thirrjes publike

- 1.1. Qyteti i Shkupit, me qëllim stimulimin e banorëve të qytetit të Shkupit (amvisëritë) për përdorimin e pajisjeve më bashkëkohore për ngrohje në shtëpitë e tyre, të cilat janë më ekonomike, më efikase nga ana energjetike dhe të pranueshme nga aspekti ekologjik, qytetarëve që kanë blerë pajisje më bashkëkohore për ngrohje – kondicionerë inverter në vitin 2019 do t'u kompensojë një pjesë të shpenzimeve të bëra gjatë blerjes së pajisjes në vlerë 50%, por jo më shumë se 15.000,00 denarë me tatimin mbi të ardhurat personale të përfshirë për amvisëri.
- 1.2. Thirrja publike do të zgjasë deri më 30 nëntor 2019 ose deri në shterimin e mjeteve financiare të parashikuara nga Buxheti i Qytetit të Shkupit për këtë qëllim, në varësi të asaj se cili kusht do të shfaqet i pari.
- 1.3. Nëse janë shteruar të gjitha mjetet financiare të parashikuara me Buxhetin e Qytetit të Shkupit për këtë qëllim, Qyteti i Shkupit do të informojë publikun në ueb-faqen e vet se Thirrja publike është ndërprerë para afatit të skadimit të periudhës për të cilin është shpallur.
- 1.4. Thirrja publike do të realizohet sipas parimit „i ardhuri i parë shërbehet i pari“.

2. E drejta për pjesëmarrje në Thirrjen publike:

- 2.1 Të drejtë për pjesëmarrje në Thirrjen publike kanë banorët e qytetit të Shkupit (në komunat: Aerodrom, Gazi Baba, Kisela Voda, Karposh, Çair, Shuto Orizare, Qendër, Gjoçe Petrov, Butel, Saraj) të cilët kanë blerë pajisje kondicionerë inverter për ngrohje për amvisërinë e tyre (objekt banimi) në periudhën nga 01.01. deri më 30.11.2019 dhe do të depozitojnë kërkesë për kompensimin e një pjese të shpenzimeve.
- 2.2 Në Thirrjen publike nuk kanë të drejtë për pjesëmarrje banorët (amvisëritë) të cilët kanë objekt banimi me lidhje në ngrohjen qendrore të qytetit pa marrë parasysh nëse atë e shfrytëzojnë apo jo, që kanë mundësi për lidhje në sistemin për ngrohje qendrore si dhe banorët (amvisëritë) të cilët kanë objekt banimi në fazën e ndërtimit dhe nuk jetojnë në të njëjtin.

3. Kushte që duhet të plotësojë aplikuesi:

- 3.1. Aplikuesi duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:
 - të ketë vendbanimin në territorin e qytetit të Shkupit (komunat: Aerodrom, Gazi Baba, Kisela Voda, Karposh, Çair, Shto Orizare, Qendër, Gjoçe Petrov, Butel, Saraj),
 - të mos ketë shfrytëzuar subvencione për ngrohjen e amvisërisë (objekt banimi) nga Qyteti i Shkupit,
 - deri në depozitim të kërkesës të ketë qenë përdorues i stufës me qymyr, dru, naftë ose mazut,
 - pajisja të jetë blerë në vitin 2019, deri në përfundimin e Thirrjes publike dhe e njëjta të jetë instaluar në adresën e banimit në letërnjoftimin e aplikuesit,
 - objekti banesor të mos jetë në fazën e ndërtimit dhe aplikuesi të jetojë në të,
 - të mos ketë lidhje me ngrohjen qendrore në objektin banesor ku do të instalohet pajisja, pa marrë parasysh nëse do të shfrytëzojë,

- të mos ketë mundësi për lidhje në sistemin për ngrohje qendrore
 - të ketë paguar (paraqitur) tatimin për objektin e banimit ku do të instalohet pajisja, përfundimisht me vitin 2018;
 - Për aplikuesit që posedojnë objekte të reja banimi, dhe të cilët nuk posedojnë kurrfarë ngrohje dhe të cilët nuk janë të kyçur në ngrohjen qendrore, nuk vlejnë kushtet e theksuara në pikat 3, nën pikën 3.1 alineja 3.

Vërejtje: Aplikuesi duhet t'i përmbush të gjitha kushtet e lartpërmendura që kërkesa e tij të pranohet. Në të kundërtën Komisioni dorëzon propozim deri te Kryetari i Qytetit të Shkupit për mos pranimin e kërkesës. Paguesa e mjeteve do të realizohet pas përfundimit të zgjedhjeve presidenciale.

4. Mënyra e aplikimit në Thirrjen publike

4.1. Për kompensimin e një pjese të shpenzimeve dhe dëshminë se kriteret për pjesëmarrje janë përmbushur, aplikuesi deri te Qyteti i Shkupit duhet t'i dorëzojë këto dokumente:

- Kërkesë për kompensim (Kërkesa mund të merret në arkivin e Qytetit të Shkupit ose të sigurohet nga faqja e internetit e Qytetit: www.skopje.gov.mk);
- Fotokopje të letërnjoftimit të vlefshëm, si dëshmi se i njëjti është banor i qytetit të Shkupit;
- Fotokopje nga numri i kërkesës së parashtruar deri te Arkivi i Qytetit të Shkupit për dhënie të vërtetimit për tatimet e paguara të pronës për objektin e banimit ku do të instalohet pajisja, përfundimisht me vitin 2018;
- Fotografi nga stufa me dru, qymyr, naftë ose mazut, të cilën e shfrytëzon;
- Fotokopje nga llogaria e transaksionit;
- Dëshmi që është realizuar blerja gjatë vitit 2019, edhe atë me origjinalin e llogarisë fiskale ose faturë me certifikatë nga bankë afariste, si dëshmi për realizimin e pagesës.

4.2. Aplikuesit që posedojnë objekte të reja, dhe të cilët nuk posedojnë kurrfarë ngrohje dhe të cilët nuk janë të kyçur në ngrohjen qendrore të qytetit, nuk duhet t'i parashtrojnë dokumentet e parapara në pikën 4.

4.3. Aplikuesi kërkesën së bashku me dokumentacionin e nevojshëm, duhet ta dorëzojë në zarf të mbyllur deri te "Komisioni për realizimin e procedurës për subvencionim të qytetarëve për furnizimin e pajisjeve më bashkëkohore për ngrohje, për vitin 2019" në arkivin e Qyteti i Shkupit, në adresën bul. Ilinden nr.82, çdo ditë pune nga ora 08:30 deri në orën 15:00.

4.4. Në zarf duhet të shkruajë: Thirrje publike për subvencionim të qytetarëve për furnizimin e pajisjeve më bashkëkohore për ngrohje, kondicionerëve inverterë për vitin 2019".

4.5. Arkivi i Qytetit të Shkupit, kërkesat e pranuar do t'i evidentojë me orën e saktë të parashtrimit (data, ora dhe minuta), me qëllim të përcaktimit të radhitjes sipas cilës do të shqyrtohen kërkesat.

5. Mënyra e realizimit të Thirrjes publike

5.1. Kryetari i Qytetit të Shkupit formon Komision për realizimin e Thirrjes publike, i cili do ta realizojë procedurën në dy faza:

- Në fazën e parë, Komisioni do t'i shqyrtojë kërkesat e arritura dhe dokumentacionin e deponuar si shtojcë, me qëllim të përcaktimit se vallë të njëjtit janë të rregullta dhe të kompletuara, dhe

- Në fazën e dytë, Komisioni do të kryejë kontrollin në terren tek të gjithë aplikuesit të cilët kanë dorëzuar dokumentacionet e rregullta dhe të kompletuara, që të konstatojë se vallë të njëjtit i kanë përmbushur kushtet e parapara me këtë Thirrje publike, dhe në veçanti të përcaktojnë se kondicionerë inverter i blerë është i instaluar në vendbanimin sipas letërnjoftimit të kërkuarit, dhe se nuk ekziston kyçje në sistemin e ngrohjes qendrore në suaza të objektit banesor ku është instaluar pajisja, se nuk ekzistojnë mundësi për kyçjen në ngrohjen qendrore të qytetit, dhe se objekti i banimit nuk është në fazë të ndërtimit, si dhe se aplikuesi jeton në të njëjtën dhe se deri në parashtrimin e kërkesës i njëjti është shfrytëzues i stufës në thëngjill, dru, naftë ose mazut.

5.2. Aplikuesi është i detyruar që t'i mundësojë qasje Komisionit deri te objekti i banimit dhe deri te hapësira ku është instaluar kondicioneri inverter i blerë.

5.3. Për kërkesat e arritura dhe të përfunduara nga pika 5.1 alineja 1, do të evidentohet lista me të dhënat e mëposhtme:

- emri, mbiemri dhe adresa,
- data dhe ora e arritjes së fletëparaqitjes së Thirrjes publike,
- shuma e kompensimit për aplikuesin dhe vlera e tatimit personal mbi pagën.

5.4. Paguesa e mjeteve do të kryhet në mënyrë të njëpasnjëshme, sipas radhës së arritjes së fletëparaqitjeve, sipas parimit „i ardhuri i parë shërbehet i pari”, pas sjelljes së aktvendimeve për miratimin e kërkesave nga ana e kryetarit të Qytetit të Shkupit dhe pas përfundimit të zgjedhjeve presidenciale.

5.5. Pas përfundimit të procedurës së tërësishme, aplikuesi duhet të mundësojë qasjen e Komisionit deri te objekti banesorë dhe deri te hapësira në të cilën është instaluar pajisja edhe gjatë viteve të ardhme, pas përfundimit të Thirrjes publike.

6. Mënyra e realizimit të së drejtës së kompensimit

6.1. Kryetari i Qytetit të Shkupit me propozim të Komisionit do të sjellë aktvendim për miratimin e kërkesës për aplikuesit të cilët i kanë plotësuar kushtet e kësaj Thirrjeje publike, dhe në rast të mos pranimit të kërkesës, në propozim të Komisionit, Kryetari i Qytetit dorëzon njoftimin me shkrim për mos pranimin e kërkesës.

6.2. Komisioni i njofton aplikuesit në afat prej 7 ditëve nga dita e parashtrimit të kërkesave, nëse të njëjtit nuk kanë parashtruar dokumentacione të rregullta dhe të kompletuara dhe ua kthen të njëjtat si shtojcë e njoftimit.

Nr. _____

SHKUP